



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 225, datë 20.06.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z. {...}, NË GJYKATËN E APELIT GJIROKASTËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për periudhën deri më datë 20.06.2023.
2. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë për periudhën deri më datë 30.06.2022, me përjashtim të çështjeve për të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.
3. Ngarkohet Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.
4. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit, z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR